

Vështrim mbi romanin “1803”, të autorit Besim Xhelili

Marinela Duri, filologe

Athinë, 10 maj 2016

Përshëndes të pranishmit dhe veçanërisht autorin e librit që sapo kam lexuar! Përfitoj nga rasti të falënderoj Bardhën për ftesën e sotme dhe kryesisht për dërgimin në pdf të romanit, gjë që më lehtësoi leximin e tij. E falënderoj gjithashtu për sugjerimin e leximit të veprës, promovimin e së cilës sot ajo moderon; me zell, profesionalizëm, shpirt artistik, me zërin e saj kumbues, Bardha përqendron vëmendjen tonë, imponon ndjekjen e ritmeve të bisedës së saj. Ndërkaq, pa kaluar cakun e një lexueseje të vëmendshme dhe kaq... (duke ditur mirë që recensën e librit e ka bërë shkrimtari, publicisti dhe kritiku i mirëfilltë - Prend Buzhala), pas leximit të kësaj vepre midis rreshtave, me mbresa të thella, shpreh bindjen time që ky roman mund të bëhet më i shituri, më i lexuari. Në fund të fundit, sa dhe ç’duhet që një libër të bëhet bestseller sot? - Fjalori i pasur, stili narrativ, përshkrimet romantiko-erotike të ngarkuara emocionalisht me figura letrare si: epifora, metafora, alegoria, krahasimi, epiteti, aforizmat, simbolizimi i shenjave të pikësimit (tre pikat, thonjëzat etj.) drama, suspens-i, anatrofia – thyerja kronologjike e ngjarjeve, që ndryshe fillojnë, ndryshe rrjedhin e ndryshe përfundojnë, romanca, informacioni dhe sigurisht një fund i lumtur-HAPPY-END, këto kërkon lexuesi bashkëkohor. Më konkretisht: drama shfaqet në roman që në fazën e parë kur protagonistët fillojnë e ndiejnë për njëri-tjetrin; që të dy kanë familje. Vetëkuptueshëm që vështirësitë e pengesat për përjetimin fshehtas të një ndjenje të tillë do t’i shoqërojnë gjithnjë e kudo, deri në fund kur protagonistin ka të sigurt vdekjen dhe në atë shtrat i duhet t’i rrëfëhet së shoqes dhe protagonistja, së shoqit. Drama, gjithashtu nuk mungon në linjën e punës – në marrëdhënie me kolegun maniak, ankthi për çdo të keqe që mund t’i vijë atij dhe familjes nga ky njeri me plagë psikike nga fëmijëria etj. Romanca pa fund përshkon tejendën e romanit. Lojërat e fjalëve, tematologjia e bisedave të tyre e bën më tërheqës librin e më të ngutshëm leximin duke nxjerrë në pah njëkohësisht nivelin e lartë të tyre intelektual, diturinë, mprehtësinë e zgjuarsinë e tyre. Thjesht, është nga ata libra që lexohen me një frymë, paçka se para HAPPY-END-it të bën të lotosh. Kjo vepër premtan për të tjera në radhë. Gjithashtu librin mund ta cilësoj edhe informativ - jo vetëm për sa i përket jetës aktuale në komunitet në vend të huaj, integritetit, organizimit në shoqata, arritjet, përcjelljes së botëkuptimit të vendasve dhe konstatimit – gjykimin tonë, të ne - shqiptarëve (që aq shumë ngjasojmë), por edhe sa i përket

të rejave, sugjerimeve indirekt të autorit tek lexuesi për libra të rinj. P.sh. Neveria e Sartrit, Vuajtjet e djaloshit Verter - Göte, Miti i Sizifit të Albert Kamysë etj., që autori përmend në libër mund të jenë për mua (por edhe për lexues të tjerë) ndjekësit e 1803 - it në sezonin e verës, kur nuk jam e angazhuar me lexim të detyrueshëm. Në përfundim do doja të lexoja disa nga aforizmat e Samirës...me te cilat pajtohem 100%. “Të qeshësh shpesh..., të fitosh respektin e njerëzve inteligjentë dhe dashurinë e fëmijëve, të dëgjosh kritikën e sinqerta dhe të durosh tradhtinë e miqve jo të vërtetë, të vlerësosh bukurinë, të zbulosh anët pozitive tek të tjerët, duke e bërë botën pak më të mirë...të dish se qoftë edhe një person i vetëm ka qenë i kënaqur nga fakti i ekzistencës tënde...ja, kjo do të thotë të kesh sukses”, shkroi ajo. “Fjalë të çiltra”, ia ktheva. “Unë nuk dua të jem një milionere, vetëm dua të jetoj si një e tillë, kjo është motoja e jetës time”, shkroi prapë, duke më kërkuar mua falje se më mërzi. “Jo, përkundrazi, mësoj...”

E sugjeroj pa ngurrim te të gjithë.

Suksese më tej!!

Marinela Duri – Filologe